

economic
initiative
for kosova



Nisma Ekonomike për Kosovën – ECIKS
Udhëzues për hartimin e studimit të fizibilitetit
Vjenë, qershor 2004

Udhëzues për hartimin e studimit të fizibilitetit (Feasibility Study)

Nëse planifikoni ndonjë projekt investiv, mënyra më e sigurtë për të vlerësuar mundësitë, shansat dhe rreziqet e projektit është hartimi i një studimi detajor, që në gjuhën ekonomike njihet si STUDIM I FIZIBILITETIT (Feasibility Study).

Përmes hartimit të këtij studimi mund të parashihet se me çfarë shpenzimesh do të ballafaqohet projekti investiv, si do të jetë pozita e ndërmarrjes ndaj konkurrencës vendore dhe asaj të huaj, cilat produkte mund të plasohen suksesshëm në treg dhe në fund si dhe sa shpejt do të mund të shpaguhen investimet (ROI).

Për t'u përgjigjur me sukses në gjithë këto pyetje qenësore, duhet të analizohen dhe të përpunohen çështjet e mëposhtme:

1. Informata të përgjithshme për projektin ekzistues:

- Përshkrimi i shkurtër i historikut të ndërmarrjes
- Pasqyrimi i ndërmarrjes ekzistuese (organigrami, bilancet eventuale të konsoliduara, etj.)
- Të dhënat mbi partnerët ndërmarrës
- Forma juridike e ndërmarrjes
- Raportet e pjesëmarrjes në kapital të partnerëve
- Pasqyrimi i shkurtër i kontratave ekzistuese (poashtu edhe të kontratave mbi Know How)
- Situata financiare e partnerëve (raportet e biznesit, bilancet e tri viteve të fundit, etj.)
- Raportet vjetore të ndërmarrjes së projektuar për tri vitet e fundit me sqarime
- Struktura organizative (organigrami, biografia e menaxherëve)
- Selia dhe vlerësimi i trojeve të ndërmarrjes
- Vlerësimi i pasurisë themelore (ndërtesat, makinat, pajisjet e ndërmarrjes)
- Ngarkesat juridike të truallit (pengu i dorës, hipoteka)
- Kërkesat aktuale nga tregu

- Strukturat e distribuimit
- Llogaritja e shpenzimeve të produkteve më të rëndësishme
- Liferuesit më të rëndësishëm
- Lënda e parë
- Ndërmarrjet konkurruese (në vend, në botën e jashtme, importet, çmimet dhe sasi të shitjes)
- Sasia e prodhimit, kapaciteti i aplikuar prodhues në tri vitet e fundit
- Çmimet e shitjes dhe sasia e shitjes për prodhimet kryesore të ndërmarrjes
- Shpenzimet e transportit
- Plani i kthimit të kredive ekzistuese
- Kamata për kreditë ekzistuese
- Plani i amortizimit të vlerës së investimit
- Shpenzimet mesatare për të ardhurat e punëtorëve, nëpunësve, udhëheqësve
- Shpenzimet e transferit të Know How

2. Të dhënat për investimet e reja

- Përshkrimi teknik i investimit të ri
- Analiza e tregut (zhvillimi aktual dhe i ardhshëm i tregut, konkurrenca, strategjitë e marketingut për produktet)
- Shpenzimet e produkteve (krahasim i shpenzimeve në mes të produkteve)
- Analiza e tregut aktual në vend (shpenzimet, shpenzimet e transportit, kohëzgjatja e liferimit, kualiteti, niveli teknik, ngarkesat për ambientin)
- Infrastrukturat ekzistuese (furnizimi me ujë, rrymë, vajëra, kapaciteti i transportit, lidhjet e trolit me rrugët transportuese, komunikacioni)

3. Investimet

- Trualli (madhësia, vlera, obligimet e mëhershme)
- Plani kohor i realizimit të projektit
- Shpenzimet për përgatitjen e truallit dhe të pajisjeve të jashtme
- Ndërtesat (madhësia, lloji, shpenzimet e ndërtimit)
- Makinat dhe pajisjet makinore
- Shpenzimet e paraprodhimit (taksat, këshillimet, kamatat për kredinë ndërtimore, etj.)
- Doganat për mallërat e importuara, shpenzimet e transportit dhe shpenzimet e ngjashme të investimit
- Lloji dhe shpenzimet për pajisjet tjera të ndërmarrjes
- Shpenzimet për blerjen e automjeteve të reja
- Plani amortizues për ndërtesa, makina dhe pajisjet e ndërmarrjes

4. Pasuria qarkulluese

- Shitja e mallit me pritje (mesatarja e kohës prej shitjes deri te pagesa)
- Blerja e mallit me pritje (mesatarja e kohës prej blerjes deri te pagesa)
- Kohëzgjatja e deponimit të lëndëve të para e shprehur në muaj
- Kohëzgjatja e deponimit të pjesëve rezervë e shprehur në muaj
- Kohëzgjatja e deponimit e lëndëve të tjera e shprehur në muaj
- Koha e deponimit të gjysëmprodukteve
- Kohëzgjatja e deponimit të produkteve finale

5. Financimi

- Financimi i paraparë vetanak dhe i huaj
- Kohëzgjatja
- “Grace” periudha
- Kamata

6. Prodhimi dhe shitja

- Shfrytëzimi aktual dhe i paraparë i kapaciteteve
- Sasitë e planifikuara të prodhimit për produktet më të rëndësishme
- Çmimet e shitjes për njësi të produkteve

7. Shpenzimet variabël

- Shpenzimet për lëndë të para për çdo njësi të prodhuar
- Nevoja vjetore energjetike në MWh dhe nevojat maksimale në MW
- Shpenzimet energjetike për një MWh
- Situata energjetike
- Shpenzimet për pjesët rezervë
- Shpenzimet tjera për energji (ujë, rrymë, nxemje, vajëra, karburante)
- Shpenzimet e transportit
- Nevojat shtesë në personel (punëtorë, specialistë, nëpunës, udhëheqës)
- Shpenzimet shtesë për çdo punëtor
- Shpenzimet e mirëmbajtjes
- Shpenzimet tjera variabël
- Shpenzimet e transferit të Know How

8. Shpenzimet fixe

- Shpenzimet shtesë për administratë
- Shpenzimet shtesë për sigurime
- Shpenzimet shtesë për personel
- Reklammat dhe shpenzimet e ndryshme të distribucionit
- Tatimet (niveli i tatimeve, mundësitë e përlogaritjes së humbjeve, lehtësimet)

Dokumentet vijuese duhet të jenë të gatshme qysh prej fillimi të përgatitjes së studimit të fizibilitetit:

- Raportet e ndërmarrjes për tri vitet e fundit
- Përfundimet vjetore të tri viteve të fundit
- Vlerësimi i pasurisë në pajisje
- Vlerësimi se a i plotëson projekti detyrimet për ruajtjen e ambientit
- Përshkrimi teknik i prodhimit
- Paraqitja detale e shpenzimeve të investimit dhe krahasimi i ofertave të liferuesve të ndryshëm
- Llogaritja e shpenzimeve për prodhim
- Planifikimi vjetor për tri vitet e ardhshme

Nisma Ekonomike për Kosovën ofron për ju kryerjen e këtyre shërbimeve dhe hartimin e analizave të këtilla. Për pyetje drejtohuni në info@eciks.org.